



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE ZHVILLIMIT URBAN

Nr. _____ Prot.

Date _____/_____/2020

MIRATOHET
KRYETAR I BASHKISË
Pjerin NDREU

DETYRE PROJEKTIMI

PËR REALIZIMIN E STUDIM PROJEKTIMIT:

HARTIMIN E PROJEKTEVE TË PËRFORCIMIT TË PALLATEVE TË DEMTUAR

NGA TERMETI dt. 26.11.2020 NË BASHKINE LEZHË

Bashkia Lezhë, me fondin e akorduar prej 63,483,700. (gjashtedhjetë e tre miliona e katerqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, kërkon të realizojë hartimin e projekteve të nderhyrjeve rehabilituese/pershtatese të nevojshme për forcimin e strukturës së objekteve që janë klasifikuar si objekte me demtime të mëdha strukturore ose demtime shumë të rënda jostrukturore (studim projektimit), për objektin: “Përforcimi i pallateve të dëmtuara nga termeti dt. 26.11.2019 në Bashkinë Lezhë”.

Bazuar në urdherin e Kryetarit të Bashkisë nr. 665, date 14/09/2020, DPTZHU, në bashkëpunim me Zyren e Rindertimit përgatiten materialin përmbledhës për hartimin të detyres së projektimit me objekt: “Përforcimi i pallateve të dëmtuara nga termeti i date 26.11.2019 në Bashkinë Lezhë” dhe konkretisht kërkohej të realizohet *Hartimi i dokumentacionit gjeometrik dhe teknik, analizes strukturore të thelluar, projektin e nderhyrjeve rehabilituese/përshatese, për ndertesat e demtuara nga termeti i dt.26.11.2019*, si përfundim i dalë nga Akt-ekspertizat e thelluara, të konfirmuara nga Instituti i Ndertimit.

Ndertesat e vleresuara të demtuara nga aktet e konstatimit vizual dhe nga Akt-ekspertizat e thelluara, të konfirmuara nga Instituti i Ndertimit, për të cilat është lenë detyrë hartimi i projekteve të përforcimit dhe nderhyjeve rehabilituese, janë 39 cope. Sipërfaqja totale e ndertimit për 39 pallateve është **74.687 m²**

Referuar vlerësimeve të aftësisë mbajtëse strukturore të ndertesave ekzistuese (**Akt ekspertizave**) të cilat, pas kërkesës së bërë ndaj Institutit të Ndertimit nga Bashkia Lezhë, janë kryer nga subjektet e kontraktuar ing. Dhimiter PAPA, ing. Altin BIDAJ dhe ing. Irakli PREMTI. Keto Akt ekspertiza, i janë dorëzuar Institutit të Ndertimit, i cili pas konfirmimit i ka përcjellë Bashkisë Lezhë për veprim.

Nga këto Akt ekspertiza, ka rezultuar se :

Si pasoje e termetit të dates 26.11.2019, ndertesat kanë pësuar demtime dhe përfundimi është që ndertesat në gjendjen ekzistuese nuk i plotesojnë kushtet e sigurise dhe qendrueshmerisë për ngarkesa statike dhe dinamike (sizmike), referuar gjendjes së pare kufitare në aftesi mbajttese si dhe kriteret e sherbimit në ulje dhe deformime referuar gjendjes së dyte kufitare (gjendjes kufitare të sherbimit) duke u bazuar në normat shqiptare në fuqi dhe Eurocode për aktivitetin sizmik të zones. **Struktura e objekteve në gjendjen ekzistuese nuk i plotëson kushtet e sigurise dhe qendrueshmerisë për aktivitetin sizmik të zones, Struktura duhet ti nënshtrohet restaurimit dhe perforcimit të elementeve strukture (themele, elemente vertikale e elemente horizontale) duke u bazuar në një projekt perforcimi strukturor mjaft të detajuar për objektet përkatëse.**

Ndertesat për cilat Akt Ekspertiza ka lënë rekomandimin e hartimit të projektit të përforcimit janë sipas listes vijuese:

Nr.	Emertimi	Adresa	
		Nr.	Rruga
1	Pallati Bashkim Ulaj	13	Zef Skiroi
2	Pallati Gurra 5	21	Kol Toma
3	Pallati tek tatimet	54	Gjergj Fishta
4	Pallati i Gjok Nikes	2	Rruga Shtraus
5	Pallati "Hasan Muca"	22	Vincenc Prenushi
6	Pallati -Skenderbeg 1	9	Mbreteresha Teute
7	Pallati -Skenderbeg 2	11	Mbreteresha Teute
8	Pallati -Skenderbeg 3	30	Abat Preng Doçi
9	Pallati Torovice 1	136	Torovice-Shkëmbi i Kuq
10	Pallati Torovice 2	128	Torovice-Shkëmbi i Kuq
11	Pallati Torovice 3	132	Torovice-Shkëmbi i Kuq
12	Pallati Torovice 4	138	Torovice-Shkëmbi i Kuq
13	Pallati Torovice 5	144	Torovice-Shkëmbi i Kuq
14	Pallati Torovice 6	142	Torovice-Shkëmbi i Kuq
15	Pallati Torovice 7	150	Torovice-Shkëmbi i Kuq
16	Pallati Torovice 8	148	Torovice-Shkëmbi i Kuq
17	Pallati shengjin 108	108	Nene Tereza
18	Pallati shengjin 102	102	Nene Tereza
19	Pallati Mbreti Gent	8	Mbreti Gent
20	Pallati Shtraus 1	8	Rruga Shtraus
21	Pallati Shtraus 2	14	Rruga Shtraus
22	Pallati Shtraus 3	12	Rruga Shtraus
23	Pallati Shtraus 4	26	Rruga Shtraus
24	Pallati Shtraus 5	38	Rruga Shtraus
25	Pallati Gjergj Fishta 1	32	Gjergj Fishta
26	Pallati Gjergj Fishta 2	26	Gjergj Fishta
27	Pallati Gjergj Fishta 3	22	Gjergj Fishta
28	Pallati Gjergj Fishta 4	18	Gjergj Fishta
29	Pallati Cim Kucana	10	Qemal Atatürk
30	Pallati 5 kate	4	Frank Bardhi
31	Pallati big market (12 kt)	18	Faik Konica
32	Pallati i Postes	29	Gjergj Fishta
33	Pallati i Pjeter Preles	39	Luigj Gurakuqi

34	Shtepi banimi 2 kate Lezhe	14	Dardania
35	Shtepi banimi 2 kate Kolsh	133	Fildane
36	Shtepi banimi 1 kat, Shenkoll	124/1	Plazhi Tale
37	Shtepi banimi 3 kat, Shenkoll	138	Shenkolli
38	Shtepi banimi 2 kat, Shenkoll	62	Anton Ceta
39	Shtepi banimi 2 kat, Shenkoll	16	Zija Shkodra

Projekti i perforcimit do të trajtojë:

- Analizen strukturore të thelluar (Sipas përcaktimeve të VKM 26 dt.15.01.2020).
- Hartimin e projekteve teknike përkatëse, te perforcimit dhe nderhyrjeve rehabilituese.
- Llogaritjet teknike dhe konstruktive të perforcimit te objekteve
- Hartimin e preventivave që përcaktojnë në mënyrë të detajuar zërat e punës
- Llogaritjen e kostos se përforcimit për çdo ndertese dhe krahasimin e vleresimin sipas VKM –së.

PROJEKTI DO TË HARTOHET NË 2 FAZA:

1. **Projekt-idenë** e cila duhet të përmbajë:

- Rilevim i zonës duke evidentuar të gjithë elementët e dallueshëm topografikë, elementët e rrjeteve të propozuara të infrastrukturës.
- Raport ku jepen arsyet e llogaritjeve dhe krahasimet që justifikojnë ndërhyrjet e propozuara.
- Përshkrim i detajuar i arsyeve dhe shkaqeve që përcaktojnë vendodhjen dhe ndërhyrjen e propozuar.
- Studim i detajuar i kthimit të kostos së investimit,
- Evidentimi i numrit të qytetarëve që përfitojnë nga investimi, si dhe pritshmeritë e projektit.
- Vizatimet përkatëse në një shkallë të lexueshme.

2. **Projekt zbatimi** (format A2, A1). Pas aprovimit të projekt-idesë nga Autoriteti Kontraktues dhe Përfituesi, hartohet Projekti teknik me materialin sa vijon:

- Projekti Arkitektonik i cili duhet të përmbajë
 - Projekt zbatimi arkitektonik (planimetri, prerje, detaje teknike, fasada, rendera).
 - Relacioni Arkitektonik
 - Preventivi
 - Planvendosje e Zonës
- Projekti Konstruktiv i cili duhet të përmbajë
 - Projekt zbatimi Konstruktiv (Sipas kushteve teknike 89' dhe Eurokodit nr.8 si dhe referuar analizave të thelluara për cdo objekt).
 - Relacioni Konstruktiv (metodat e llogaritjes, krahasime variantesh etj)
 - Preventivi (krahasim tekniko-ekonomik)
 - Specifikime teknike
- Projekti Elektrik i cili duhet të përmbajë
 - Projekt zbatimi Elektrik (Rrufepritësi dhe Tokëzimi i Panelit Elektrik)
 - Relacion Teknik
 - Preventiv
- Projekti Mbrojtjes Kundër Zjarrit i cili duhet të përmbajë
 - Projekt zbatimi Mbrojtjes Kundër Zjarrit
 - Relacion Teknik
 - Preventiv
 - Specifikime teknike
- Projekti Hidrosanitarë i cili duhet të përmbajë

- Përshtatja e rrjetit ekzistues të objektit me ndryshimet e mundshme.
 - Relacion Teknik
 - Preventiv
 - Specifikime teknike
- Preventivi Total me të gjithë zërat e punimeve dhe krahasimin sipas VKM-së për percaktimin e kostove të ndërtimit sipas rretheve.
 - Grafiku i realizimit të punimeve.

Të dhëna të përgjithshme dhe gjëndja ekzistuese e objekteve

Vendndodhja: Në territorin e Bashkisë Lezhë.

Përshkrimi i Projektit : Objektet ndodhen në territorin e Bashkisë Lezhë.

Ndertesat kolektive (shumekateshe) dhe individuale, që do të merren në shqyrtim janë ndërtuar kryesisht para viteve 1990.

Godinat janë kryesisht një, dy, tre, kater dhe pese kateshe, me themele me mur guri, muret mbajtese jane murature tulle, jane te mbuluara me cati e tjegulla, si dhe me soleta betonarme kryesisht me soletone apo traveta, por ka edhe ndertesat me te larta, deri 12 kate, të ndërtuara vitet e fundit, me strukture skelet beton arme.

Në përgjithësi janë pa breza betonarme në kuoten 0.00, ndersa kanë breza të dobët në mbulesat e nderkateve.

Gjatë viteve këto objekte janë amortizuar dhe pas goditjes sizmike kanë paraqitur probleme serioze nga ana konstruktive .

Çatitë janë të prishura ose pjesërisht janë riparuar nga vete banoret. Fasadat e kanë humbur identitetin e tyre pasi në to janë bërë ndryshime me çarje të reja.

Duke bërë vlerësimin e thelluar të këtyre banesave, përcaktojmë nëse është e mundur përforcimi i tyre nëpërmjet projekteve të përforcimit dhe nga analiza ekonomike gjejmë se cilet objekte janë me leverdi ekonomike që të përforcohen dhe cilet jo .

Duke bërë ndërhyrjet e përforcimit të ndertesës, si dhe në fasadë dhe çati (mbulesa), ne u japim siguri, jetegjatesi dhe një vlerë të re këtyre objekteve,

Vlerësimi fizik i objekteve:

Gjatë viteve këto objekte janë amortizuar dhe kanë shfaqur probleme në themele, në mure mbajtese e ndares, në soleta të nderkateve, në fasada dhe çati (mbulesa), dhe nga një vlerësim paraprak i kryer gjatë Akt ekspertizës, rezultoi se:

Kanë nevojë për një vlerësim të thelluar teknik ekonomik, ku behet vlerësimi i perfundimtar mbi leverdine ekonomike të projektit të përforcimit të ndertesës, kosto e përforcimit/rehabilitimit duhet të jetë me pak se 70% e koston minimale të ndërtimit sipas VKM.

Objektivi i projektit : Rikonstrukcion i godinave, përforcimi i struktures mbajtese, përforcimi i çatisë apo soletes se tarraces, rikonstrukcion i fasadave.

Qellimi i projektit : Projekti i përforcimit do të garantojë qëndrueshmërinë e ndertesave dhe kthimin e përdorimit normal të tyre.

1. Kërkesa projektimi të përgjithshme për përforcimin e godinave

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standartet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri.

- ❖ Ndërhyrja për riparimin apo riberjen e çatisë është e domosdoshme pasi ajo është e dëmtuar në disa vende.

- ❖ Konsulenti duhet të verifikojë nëse ka probleme të tabanit, themeleve, mureve, trareve, kollonave, lidhjeve ndermjet tyre , për të siguruar parametrat normale të qëndrueshmërisë së ndertesave .
- ❖ Projektuesi duhet të japë të gjitha detajet për të gjithë llogaritjet dhe konkluzionet perfundimtare , sipas normave në fuqi.
- ❖ Fasada e godinave, të jetë e tillë që të mirëmbahet lehtë, të evitohen sipërfaqet e mëdha të xhamit atje ku është e mundur, kurse ngjyrat e fasadës të jenë të pershtatshme dhe në harmoni me ndertesat rreth, në mënyre që objekti të bëhet më atraktive për qytetarët.

❖ Muret mbajtëse

Konsulenti do të japë të gjitha detajet e përforcimit të muraturës mbajtëse në rastin kur ajo paraqitet me probleme. Në rast të mureve me çarje, konsulenti do të tregojë mënyrën e përforcimit të tyre.

Në rastin e ndërtimeve të mureve të reja të domosdoshme apo të elementeve betonarme apo metalike përforcues , të jepet në projekt/preventiv mënyra e lidhjes së tyre me skeletin apo muret e ndertesës ekzistuese.

❖ Suvatimet

Objekti i përforcuar dhe rikonstruktuar duhet të suvatohet nga jashtë.

Në pjesët e dëmtuara, suvatimet e mureve dhe tavaneve do të kryhen në të gjithë sipërfaqjen përkatëse, në varësi të përforcimit, duke ruajtur shtresën e parë ekzistuese ku të mundet në mure.

Të gjitha shtresat e tjera në rast se janë të dëmtuara do të hiqen pa dëmtuar muret, nëse është e mundur.

Përsa i përket suvatimeve të jashtme do të jenë në varësi të llojit të ndërhyrjes që parashikon projekti, nëse do të restaurohet sipërfaqja ekzistuese ose do të rishikohet e gjitha sipas konceptit të ri që kërkon fasada.

Për xokolin të parashikohet suvatim i ri me granil pas pastrimit të suvatimit të vjetër.

❖ Lyerja e sipefaqeve të brendshme dhe të jashtme.

Muret e jashtme do të lyhen me boje akrilike, Siperfaqet e brendshme (mure, tavane) me boje hidroplastike.

❖ Unifikimi i fasadave

Ku është e mundur do të propozohet unifikimi i fasadave në katet e para. Edhe ngjyrat e tendave që vendosin bizneset duhet të jenë të njëjta.

❖ Hartimi i Preventivit.

Kosto totale e ndërhyrjes do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike duke marrë parasysh edhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standartet e pranuar.

Grafikun e punimeve, të detajuar sipas zërave të punës, si dhe kohëzgjatja e nevojshme për realizimin e punimeve

Preventivin e plotë vlerësues të veprës bazuar në manualin e preventivimit të aprovuar nga Këshilli i Ministrave. Për zërat e punimeve që nuk janë në këtë manual, duhet të bëhen analizat e veçante e çmimeve .

Specifikime teknike per zerat e punimeve qe do te kryhen.

2. Standartet

Standarte në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që kërkojnë normat e sotme ne fuqi si KTP-N2-89 dhe ato europiane,

Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standateve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse ne dokumentat e projektit.

Projektuesi duhet të rekomandojë dhe prezantoje standartet e reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës sipas ligjeve ne fuqi .

Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit:

Projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

3. Realizimi i Projektit

Projekti i paraqitur për “Hartimin e projekteve të përforcimit të pallateve të demtuar nga termeti i dt.26.11.2019, në Bashkinë Lezhë”

Duhet të përmbajë:

- **Faza e I (Projekt ideja)**

- Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse.
- Rilevim i zonës duke evidentuar të gjithë elementët e dallueshëm topografikë, elementët e rrjeteve të propozuara të finfrastrukturës.
- Vizatimet përkatëse në një shkallë të lexueshme 1: 5000 ose 1:10000.
- Një raport ku jepen arsyet llogaritjet dhe krahasimet që justifikojnë ndërhyrjet propozuara.
- Përshkrim i detajuar i arsyeve dhe shkaqeve që përcaktojnë vëndodhjen dhe ndërhyrjen e propozuar.
- Studim i detajuar i kthimit të kostos së investimit,
- Evidentimi i numërit të qytetarëve që përfitojnë nga investimi, si dhe pritshmeritë e projektit.
- Paraqitja e varianteve të ndërhyrjes,perforcimit në bazë të rezultateve të vlerësimit me argumentimet përkatëse.
- Të paraqiten variantet ide të sistemeve teknologjike dhe të tjera të përmendura në këtë detyrë projektimi

- **Faza e II (Projekt Zbatimi)**

- Projekti Arkitektonik i cili duhet të përmbajë
 - Projekt zbatimi arkitektonik (planimetri, prerje, detaje teknike, fasada, rendera).
 - Relacioni Arkitektonik
 - Preventivi
 - Planvendosje e Zonës
- Projekti Konstruktiv i cili duhet të përmbajë
 - Projekt zbatimi Konstruktiv (planimetri, prerje, detaje teknike. Sipas kushteve teknike 89' dhe Eurokodit nr.8 si dhe referuar analizave të thelluara për cdo objekt).
 - Relacioni Konstruktiv (metodat e llogaritjes, krahasime variantesh etj)
 - Preventivi (krahasim tekniko-ekonomik)
 - Specifikime teknike
- Projekti Elektrik i cili duhet të përmbajë
 - Projekt zbatimi Elektrik (Rrufepritësi dhe Tokëzimi i Panelit Elektrik)
 - Relacion Teknik
 - Preventiv
- Projekti Mbrojtjes Kundër Zjarrit i cili duhet të përmbajë
 - Projekt zbatimi Mbrojtjes Kundër Zjarrit
 - Relacion Teknik
 - Preventiv
 - Specifikime teknike
- Projekti Hidrosanitarë i cili duhet të përmbajë
 - Përshtatja e rrjetit ekzistues të objektit me ndryshimet e mundshme gjatë projektimit të përfundimit të objekteve.
 - Relacion Teknik
 - Preventiv
 - Specifikime teknike
- Preventivi Total me të gjithë zërat e punimeve dhe krahasimin sipas VKM-së për percaktimin e kostove të ndërtimit sipas rretheve.
- Grafiku i realizimit të punimeve.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhen objektet. Distancat e lejuara si dhe kriteret urbane të zonës në fjalë.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia Lezhe, Instituti i Ndërtimit, ASHK, etj. që i nevojiten gjatë hartimit të projekteve.
- Sipërfaqet funksionale të rrethimeve dhe sistemeve të jashtme, etj.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standartin e kërkuar të projektit.

Organizimi, plani i punës dhe stafi i kërkuar

Projekti do të kryhet në bashkëpunim me Bashkinë Lezhe.

Stafi teknik i operatorit duhet të jetë i përbërë nga :

- Arkitekt.
- Inxhinier ndërtimi, profili Strukturist.
- Urbanist.
- Inxhinier gjeodet.
- Inxhinier ndërtimi, Preventivues

- Inxhinier mjedisi.
- Inxhinier elektrik.
- Inxhinier hidro.
- Inxhinier mekanik.
- Inxhinier gjeolog.
- Ekspert në sistemet MNZ.
- Ekspert të certifikuar në eficiencen energjitike.
- Staf mbështetës për fushat e mësipërme.

Raportimi

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dwg” (AutoCAD 2010). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në CD).

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit të përforcimit dhe arkitektonik
- Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.
- Preventivi i plotë i kushtimit të veprës.

Paraqitja e vizatimeve.

Vizatimet në fazë projekt zbatimi duhet të paraqiten në format A2, A3, të jenë të lexueshme dhe të përmbajnë si minimum fletët si më poshtë:

1. Topografinë e gjëndjes egzistuese në të cilën të jenë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjëndjen e sotme (me leje dhe pa leje)
2. Projektet Teknike të jenë në Shk. 1:100

4. Sqarime të fundit

Kësaj detyre projektimi i bashkëlidhen Akt ekspertiza më të dhënat e nevojshme për secilin e nga objektet e demtuara dhe te planifikuar për përforcim.

Ne lidhje me perlllogaritjen e fondit limit.

Në nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; parashikohet se “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme.

2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës.

Njësia konstaton se sipërfaqja totale e ndertimit te 39 pallateve eshte **74.687** m². Per kryerjen e *procedurës me objekt: Hartimin e projektit te nderhyrjeve rehabilituese/ pershatese te nevojshme per kthimin e struktures se objekteve qe jane klasifikuar si objekte me demtime te medha strukture ose demtime shume te renda jostrukture ne bashkine lezhe*”, përlllogaritja e fondit

limit është për secilin zë të preventivit, në përputhje me Vendimin Nr. 26, datë 15.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Per kryerjen e aktekspertizes se thelluar ne ndertesdat e demtuara”.

Tabela llogaritese per sherbimet e projektimit, ndertesat me demtime sipas Akt Ekspertizes

Nr.	Emertimi	Adresa		Nr. Kate	Siperfaqe
		Nr.	Rruga		
1	Pallati Bashkim Ulaj	13	Zef Skiroi	5	900
2	Pallati Gurra 5	21	Kol Toma	4	1.000
3	Pallati tek tatimet	54	Gjergj Fishta	5	2.050
4	Pallati i Gjok Nikes	2	Rruga Shtraus	8	3.600
5	Pallati "Hasan Muca"	22	Vincenc Prenushi	3	1.800
6	Pallati -Skenderbeg 1	9	Mbreteresha Teute	4	1.200
7	Pallati -Skenderbeg 2	11	Mbreteresha Teute	3	1.500
8	Pallati -Skenderbeg 3	30	Abat Preng Doci	4	820
9	Pallati Torovice 1	136	Torovice-Shkemb i Kuq	4	1.680
10	Pallati Torovice 2	128	Torovice-Shkemb i Kuq	5	1.025
11	Pallati Torovice 3	132	Torovice-Shkemb i Kuq	5	1.025
12	Pallati Torovice 4	138	Torovice-Shkemb i Kuq	5	1.025
13	Pallati Torovice 5	144	Torovice-Shkemb i Kuq	5	1.025
14	Pallati Torovice 6	142	Torovice-Shkemb i Kuq	4	820
15	Pallati Torovice 7	150	Torovice-Shkemb i Kuq	4	1.680
16	Pallati Torovice 8	148	Torovice-Shkemb i Kuq	5	1.025
17	Pallati shengjin 108	108	Nene Tereza	5	2.250
18	Pallati shengjin 102	102	Nene Tereza	5	2.400
19	Pallati Mbreti Gent	8	Mbreti Gent	5	1.050
20	Pallati Shtraus 1	8	Rruga Shtraus	5	1.150
21	Pallati Shtraus 2	14	Rruga Shtraus	5	1.000
22	Pallati Shtraus 3	12	Rruga Shtraus	7	5.950
23	Pallati Shtraus 4	26	Rruga Shtraus	8	3.520
24	Pallati Shtraus 5	38	Rruga Shtraus	11	5.280
25	Pallati Gjergj Fishta 1	32	Gjergj Fishta	4	2.400
26	Pallati Gjergj Fishta 2	26	Gjergj Fishta	4	1.280
27	Pallati Gjergj Fishta 3	22	Gjergj Fishta	3	780
28	Pallati Gjergj Fishta 4	18	Gjergj Fishta	4	1.080
29	Pallati Cim Kucana	10	Qemal Ataturk	5	2.600
30	Pallati 5 kate	4	Frank Bardhi	5	850
31	Pallati big market (12 kt)	18	Faik Konica	12	9.668
32	Pallati i Postes	29	Gjergj Fishta	5	1.450
33	Pallati i Pjeter Preles	39	Luigj Gurakuqi	9	8.100
34	Shtepi banimi 2 kate Lezhe	14	Dardania	2	210
35	Shtepi banimi 2 kate Kolsh	133	Fildane	2	400
36	Shtepi banimi 1 kat, Shenkoll	124/1	Plazhi Tale	2	140
37	Shtepi banimi 3 kat, Shenkoll	138	Shenkolli	3	548
38	Shtepi banimi 2 kat, Shenkoll	62	Anton Ceta	2	197
39	Shtepi banimi 2 kat, Shenkoll	16	Zija Shkodra	2	209
Siperfaqe totale (m2)					74.687